

VENDIM
Nr.197, datë 24.3.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “KODËR KAMËZ – KAMËZ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kodër Kamëz - Kamëz”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokën arë, me një sipërfaqe prej 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m², me vlerë 103 290 (njëqind e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë; për tokën truall, me një sipërfaqe prej 408 (katërqind e tetë) m², me vlerë 5 305 251 (pesë milionë e treqind e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë dhe për objekte me vlerë 8 440 699 (tetë milionë e katërqind e dyzet mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 13 849 240 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 410 000 (katërqind e dhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 13 849 240 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.4.2010 dhe të përfundojë më 30.6. 2010.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZVRPP”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronari për të cilin është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procedurat e regjistrimit për pasurinë e zërit “Truall” dhe të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarit, për të cilin është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, pasi të ketë marrë konfirmimin e zyrës respektive të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZVRPP”, sipas listës bashkëlidhur, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË (TOKË+OBJEKTE) E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
 “KODËR KAMËZ-KAMËZ”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Vërtetim pronësie nr.pasurisë	Sip. Përgj,m ²	Lloji i pasurisë						Objektet	Vlera lekë	Shuma në lekë	Shënime
							Truall			Arë						
							m ²	Çmimi	Vl.lekë	m ²	Çmimi	Vl.lekë				
1	Shkëlqim Marjana		Hajdari	8320	1/81	Nd.125							Lokal 1kt	2037374	2037374	Konf.zvrpp
2	Enver		Zyberaj	2066	81/11	2366	66	2650	174900						174900	Plotësim.dok.
3	Ramazan		Nika	2066	129/148	Tr.400, nd.252	100	2650	265000				karburant	2670234	2935234	Konf.zvrpp
4	Isuf		Bendo	2066	42 dt.23.2.05	37.5	5	2650	13250				Lokal 3kt	1530522	1543772	Konf.zvrpp
5	Bashkëpronarët		Ismaili	8320	1/142	440	237	20473	4852101						4852101	Konf.zvrpp
6	Bashkëpronarët		Zyberaj	2066	953 dt.7.12.05	172							Mur.rreth.	1200644	1200644	Konf.zvrpp
7	Qemal		Jonuzi	2066	112 dt.28.4.07	13.5							lokal	1001925	1001925	Konf.zvrpp
8	Petro		Gjergji	2066	81/20	1064				62	626	38812			38812	Konf.zvrpp
9	Sabri		Spahiu	2066	81/18	1024				35	626	21910			21910	Konf.zvrpp
10	Riza		Maloku	2066	129/241	2308				68	626	42568			42568	Konf.zvrpp
	Shuma						408		5305251	165		103290		8440699	13849240	

